



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Nr.01-060/01-13206/23 datë:29.05.2023



Npi – 01/219 datë:05.06.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e mbajtur më: 05.06.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
E mbajtur më datën: 05.06.2023 (e hënë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesja: znj.Besartë Musliu-Spahija, Anëtarët: z.Hasan Avdyli, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe drejtori i DSHMS-së, z.Isa Haxhiu.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit znj.Besarta Musliu-Spahija, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2023 dhe 28.04.2023
2. Informatë e përgjithshme nga DSHMS,
3. Informat nga DSHMS- mbi ecurinë e punëve të Qendrave të Mjeksisë Familjare në Fshatra,
4. Të ndryshme.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2023 dhe 28.04.2023

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, Vërejtja ime është sa i përket procesverbaleve, se duhet për secilin muaj me na ardhur procesverbalet, sepse pastaj kur po vonohen po e humbin kuptimin, mirëpo sidoqoftë unë jam për me kalua të dyja procesverbalet.

***Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalet, nga mbledhjet e mbajtura më 28.03.2023 dhe 28.04.2023.**

Pika 2

Informatë e përgjithshme nga DSHMS

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Fjalën ja dha Isa Haxhiut drejtor i DSHMS-së.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, lexoi Informatën në tërësi, në fund pasi lexoi tha nëse ka dikush ndonjë pyetje unë do të përgjigjem (shih dokumentin).

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Faleminderit për Informatën, hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për Informatën, unë e kam lexuar informatën urojë që të jetë puna edhe në teren kështu. Thatë se te Nënati-Lehona i kemi 76 ndërsa krejt kërkesa 116.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Jo, kërkesat tjera janë të natyrave tjera ndërsa këto 76 për Nënati-Lehona janë të gjitha të aprovuara. Më duhet ta theksojë se kemi një problem me kandidatët të cilat janë të martuara në Kosovë dhe nuk e kanë letërnjoftimin e Kosovës për shkak të shtetësisë. Kemi një rast nga Shqipëria e martuar në Kosovë që nuk ka letërnjoftim por vetëm një kartë të identitetit, prandaj ne duhet me amandamentuar vendimin e Kuvendit për Nënati-Lehona.

z.Reshat Mujota; Unë do ta përkrahu këtë ndryshim.

Pika 3

Informat nga DSHMS- mbi ecurinë e punëve të Qendrave të Mjekësisë Familjare në Fshatra
Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Fjalën ja dha Isa Haxhiut drejtor i DSHMS-së.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Konkursi është hapur për 4 mjekë 2 për Petrovë dhe 2 për Godanc. Po ashtu e kemi hapur konkursin për laborantë për fshatin Pjetërshticë.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Pyetja e parë për Drejtorin është kur pritët me u rregulluar rëntgeni?

Pyetja e dytë është ka të bëjë me vizitat familjare e që lidhet me furnizimin me oksigjen të pacientëve, pyetja është a nuk ka QKMF-ja oksigjen apo pacienti e ka për obligim me siguruar vetë?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Për sa i përket pyetjes së parë ne kemi shpallë dy herë konkurs për me rregulluar rëntgenin dhe dy herë ka dështuar. Siç e dini rëntgeni është donacion nga Japonia, ky është një aparat i sofistikuar për të cilin nuk ka shumë firma që e mirëmbajnë, mu për këtë arsye një firmë nga Gjakova ka krijuar monopol dhe nuk konkurron me mjetet që ne i kemi planifikuar për mirëmbajtje. Është indikativë kjo çështje sepse është e lidhur me sistem dhe ditën kur i ka dalë afati kontratës rëntgeni është prishë. Ne shpalljen e kemi bërë me 200 mijë euro kjo firmë nuk ka konkurruar, e kemi bërë 6 mijë euro nuk kanë konkurruar. Edhe më indikativë është fakti se ata kanë mundësi me prishë rëntgenin qëllimisht. Ata po i kërkojnë 28 mijë euro për mirëmbajtje vjetore. Kjo kompani në të cilën është baba me dy djemte është nga Gjakova dhe unë i njohë mirë. Sa i përket oksigjenit, pacientët kërkojnë për me u a lënë bocën në shtëpi dhe këtë ne nuk mund ta bëjmë sepse ato na nevojiten në QKMF. Ka aparate që mund të blihen e që e krijojnë vetë oksigjenin.

z.Reshat Mujota; Te konkursi i QPS-së çka është duke ndodhur?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Edhe këtu ka pasur konkurs dhe ka dështuar me arsyetimin se ka pasur ankesa.

Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 10:43h.

Procesmbajtësi:

Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Besartë Musliu-Spahija

